



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.435/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova kryesuese, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e paraqitur nga Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paraqitur nga Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, Anr.435/2025 e datës 07.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 07.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën me numër Anr.435/2025, të parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), më 7 shkurt 2025, aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje, në Prishtinë, gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore kanë identifikuar shkelje të pretenduara, nga kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik LDK, z. Hysen Cekaj i cili shfrytëzon fëmijë fare të vegjël të cilët shfaqen duke bërë thirrje politike për kandidatin për deputet në fjalë. Parashtruesi i ankesave thekson se me këto veprime kandidati dhe subjekti politik LVV kanë bërë shkelje të nenit 5, paragrafit 3 të Rregullores për Fushatën Zgjedhore nr. 07/2024.

Më tutje në ankesë parashtruesi i ankesës marrë parasysh interesin sa më të mirë të fëmijëve, jo rastësisht ligjvënësi ka sanksionuar çdo rrethanë ku persona nën 15 vjeç marrin pjesë në

fushatë dhe thirrje politike, ashtu siç LDK ka bërë me postimin e videos, ka kërkuar nga PZAP që ankesën ta gjej të bazuar dhe të nxjerr vendim sanksionues përkitazi me intensitetin e shkeljes, si dëshmi ka paraqitur linkun përkatës.

Më datë 08.02.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me 08.02.2025 në ora 18:30.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 09.02.2025, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e ka kundërshtuar ankesën si të pabazuar, pretendimi se subjekti politik LDK dhe kandidati Hysen Cekaj, ka shkelur nenin 5 paragrafi 3, të Rregullores Zgjedhore 07/2024 konsiderojmë se ligjërisht nuk qëndron.

Në këto raste nuk kemi të bëjmë me shkelje të LZP e as rregulloreve zgjedhore, sepse fëmiu i shfaqur në video është vet djali i Hysen Cekajt dhe për këtë kemi bashkëngjitur certifikatën e lindjes si prove dhe pëlqimin, veçse meqë fëmiu ka lindur në Gjermani, certifikata është në gjuhën gjermane.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se subjekti politik në fjale nuk ka bere shkelje të nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores NR.07/2024, i cili përcakton se*Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore, nuk mund të behet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve. Mbi bazën e provave me saktësisht fotografitë e paraqitura nuk mund të vërtetohet se fëmijët kane qene pa përcjelljen e prindërve. Në përgjigjen në ankesë si provë ka bashkëngjitur certifikatën e lindjes së fëmijës dhe vërtetimin/pëlqimin nga ana e prindërve në të cilën theksohet se "...si prindër me vullnet plotësisht të lirë dhe me synimin për të qenë sa më transparent si kandidat dhe si familje, kemi publikuar mesazhin e djalit tonë, S.Ç i ri, drejtuar familjarëve dhe gjithë përkrahësve tanë".*

Ne anën tjetër neni 117 par. 3 LZP, kur vendos për ankesat PZAP bazohet në prova të qarta dhe bindëse. Prandaj nuk qëndrojnë pretendimet e theksuara në ankese.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, pasi që ankesa e parashtruesit ka qenë sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nënin 117 paragrafi 3, nëni 118 paragrafi 1 të LZP-së, nëni 5 paragrafi 3 të Rregullores NR.07/2024, për Fushatën Zgjedhore, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.435/2025 më datën 10.02.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nënit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.